

~~TRANSCRIPT~~

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Kuvendi i Kosovës  
Mbledhja plenare e Kuvendit

Procesverbal, shtator 2002-9-30

Prishtinë, më 26 shtator 2002, ora 10.00  
Ndërtesa e Kuvendit në Prishtinë, salla plenare

Mbledhjen e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit.  
Nga ana e kyesuesit u propozua ky

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës,
  - 2.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Hipotekat (2002/4),
  - 2.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme,
  - 2.3. Shqyrtimi i propozimit konsesual të Kryesisë lidhur me kundërshtimin e koalicionit "Kthimi" ndaj disa dispozitave të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm,
  - 2.4. Shqyrtimi i rekomandimeve të Panelit të posaçëm lidhur me kundërshtimin e koalicionit "Kthimi" ndaj disa dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë,
3. Pyetje.

1. U miratua rendi i ditës siç ishte propozuar nga ana e kryesuesit.

Kryesuesi në fillim i informoi deputetët për zhvillimin e ngjarjeve jashtë Kuvendit, përkatësisht për protestën-grevën e urisë, e cila ka filluar sot para hyrjes së ndërtesës së Kuvendit, e organizuar nga Këshilli i nënave dhe i anëtarëve të familjeve të të zhdukurëve dhe të pengjeve të luftës. Z. Daci tha se do të takohet sot në mesditë me përfaqësuesit e këtij Këshilli, ku do t'i informojë ata se Kuvendi ka formuar një Komision të veçantë, i cili do të merret me çështjen e të zhdukurëve dhe pengjeve të luftës.

2. Kryesuesi iu drejtua deputetëve të Kuvendit me fjalët se Ju e keni marë me kohë Projektin Ligjin për hipotekat (2002/4) dhe Projektligjin për Krijimin e Regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme (2002/5). Ai tha se në këtë fazë (faza e parë e shqyrtimit të ligjeve), shqyrtimi bëhet vetëm për qëllimet dhe aspektet e përgjithshme të projektligjeve e jo për hollësitë e tyre.

Kryesuesi, ftoi sponsoruesin e dy projektligjeve, ministrin e Shërbimeve Publike z. Jakup Krasniqi që të flasë për qëllimin dhe arsyeshmërinë e tyre.

Z. Krasniqi shpalosi para deputetëve qëllimet dhe përmbajtjen e dy projektligjeve të cekur më lartë. Ai tha se zhvillimi i ekonomisë mbi bazën e tregut të lirë, zvogëlimi i papunësisë, rritja e të hyrave, përmirësimi i mirëqenjes, së qytetarëve, janë përparsitë kryesore të Qeverisë së Kosovës. Qeveria në bashkëpunim me faktorët ndërkombtarë që veprojnë në Kosovë, sipas tij janë duke krijuar infrastrukturën ligjore për t'i nxitur ndërmarrësit privatë (të brendshëm dhe të jashtëm) për investime të reja dhe afarizëm të suksesshëm në Kosovë. Në shërbim të kësaj politike dhe këtij qëllimi, tha ai, janë edhe dy projektligjet e propozuara:

Projektligji për themelimin e Regjistrimit të të Drejtave në Pronën e Paluajtshme. Këto shtrajnë rrugën e shëndrrimit të posedimit mbi tokën në atë të pronësisë private, sigurojnë

funksionimin e mirë të tregut të palujtshmërive, ndihmojnë sistemin e tatimit dhe forcojnë sundimin e ligjit në Kosovë. Projektligji definon përgjegësitë e Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe zyrave komunale kadastrale.

Sipas këtij Projektligji, tha z. Krasniqi, pronë e paluajtshme janë: toka, ndërtesat dhe banesat. Të drejtat janë: pronësia, hipotekat, servitutet dhe të drejtat e shfrytëzimit të tokës në pronësi shoqërore dhe shtetërore. Pas themelimit të Regjistrimit, asnjë bartje e të drejtave për pronën e paluajtshme nuk do të ketë efekt nëse nuk është regjistruar në përputhshmëri me ligjin. Qytetarët do të kenë qasje të lirë sa i përket shënimeve të futura në Regjistrim.

Projektligji për Hipotekat, sipas tij, do t'i nxis institucionet financiare për t'i shtuar huadhëniet. Ky projektligj thjeshtëson huadhënien dhe procesin e regjistrimit të sajë, qartëson obligimet e palëve nga hipoteka, dispozitat për dokumentin e hipotekës, si bartjen dhe ndërprerjen e hipotekës.

Projektligji tha z. Krasniqi paraqet konceptin e procedurës "jashtëgjyqësore" për shitjen e pronës së paluajtshme, e cila është objekt i hipotekës, që i lejon pengmarrësit që ta shes pronën e paluajtshme të ndërmarrëjes së regjistruar, pa kaluar fare nëpër procedurën gjyqësore.

Për implementimin e Projektligjit për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave për Palujtshmëritë, tha z. Krasniqi, duhen edhe shtatë muaj pas miratimit të këtij ligji, për ta krijuar dhe zhvilluar Regjistrin.

Projektligji për Hipotekat do të hyjë në fuqi (pas miratimit) në ditën e implementimit të Regjistrimit të të Drejtave për Pronën e Paluajtshme.

Projektligjet që u janë dërguar Kuvendit të Kosovës për miratim, përveç tjerash, kanë një rëndësi të madhe për zhvillim social – ekonomik të Kosovës, përfundoi z. Krasniqi dhe u bëri thirrje deputetëve të Kuvendit që t'i miratojnë ato.

Kryesuesi e hapi shqyrtimin për Projektligjin lidhur me hipotekat.

Fadil Geci pati vërejtje në disa dispozita (neni 2 pika 2, neni 4, pika 5, neni 10, pika 1, neni 10 pika 3) të Projektligjit për Hipotekat. Ato, sipas tij, duhet të riformulohen, ngase

siç janë dhënë në projektligj, më shumë i favorizojnë ndërmarrjet tregtare në krahasim me ato prodhuese.

Berat Luzha tha se e përkrah në tërësi Projektligjin për Hipotekat, por kishte vërejtje në nenin 24 të tij.

Bujar Dugolli tha se e përshëndet punën e hartuesit të këtij projektligji dhe duhet që atë ta miratojmë në parim, kurse vërejtjet eventuale t'u dërgohen komisioneve përkatëse të Kuvendit, ku do të shqyrtohet ai.

Muhamet Neziri ceku se me miratimin e këtij projektligji dhe të ligjeve tjera, do krijohet një ambient i sigurtë për nxitjen e investitorëve (të brenshëm dhe të huaj). Po ashtu kjo do të ndikojë në formimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm bankar, bashkimin e mjeteve të ndërmarrjeve dhe dhënien e kredive me mundësi të sigurimit dhe qarkullimit të kapitalit. Ai, shtoi se duhet përkrahur këtë projektligj, i cili mundëson zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Haki Shatri tha se ky Projektligj është propozuar nga Qeveria e Kosovës me përparsi nga fusha e legjislacionit. Por, pati vërejtje parimore se gjatë hartimit të tij është përdorur një gjuhë e stilit të lartë dhe nuk është shumë e kuptueshme për shtresat e gjëra të shoqërisë. Ai shprehu mendimin se duhet të miratohet propozimi i Qeverisë.

Kryesuesi tha se ky Projektligj, me gjitha vërejtjet e juaja duhet t'u dërgohet komisioneve përkatëse të Kuvendit, të cilat do të merren me shqyrtimin e tij dhe i ftoi deputetët për deklaram.

Pas numrimit të votave rezultati ishte:

Për ishtin 79 vota,

Kundër asnjë, dhe

Abstenim 1 votë.

Kryesuesi e hapi shqyrtimin për Projektligjin për Themelimin e Regjistrisë të së Drejtave për Pronën e Paluajtshme.

Fadil Kryeziu kërkoi sqarim nga ministri Krasniqi dhe tha se a do të ishte në rregull sikur të miratohet Projektligji për Hipotekat para Projektligjit për Themelimin e Regjistrisë.

Muhamed Kelmendi tha se në tekstin e këtij Projektligji vërehet shprehja "ligji i aplikueshëm" dhe duhet hequr këtë shprehje nga teksti i spastruar i projektligjit e të nxirret një ligj gjithëpërfshisës, i cili rregullon këtë materie.

Kryesuesi tha se gjatë fazave të procedimit të projektligjit, sponsoruesi dhe komisionet përkatëse do të kenë parasysh vërejtjet dhe propozimet tuaja.

Kryesuesi paraqiti për votim këtë Projektligj, Rezultati ishte si vijon:

- për 97 vota,
- kundër asnjë,
- abstenim asnjë.

Kryesuesi konstatoi se të gjithë deputetët parimisht e miratuan Projektligjin për Themelimin e Regjistrisë të së Drejtave për Pronën e Paluajtshme dhe ai do t'u dërgohet komisioneve përkatëse të Kuvendit.

Pasoi pushimi 20 minutësh.

2.3. Kryesuesi hapi shqyrtimin për propozimin konsesual të kryesisë së Kuvendit në përgjigje të kundërshtimit nga ana e koalicionit "Kthimi" të disa dispozitave të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm.

Oliver Ivanoviq tha se në emër të koalicionit "Kthimi" në shenjë proteste nuk kemi prezentuar në pjesën e parë të mbledhjes plenare të Kuvendit, me arsyetim se nuk është siguruar transporti i disa delegatëve të këtij koalicioni.

Kryesuesi tha si kupton shqetsimet e tyre dhe ka kërkuar nga Qeveria që ta rishiqojë buxhetin për të lejuar mjete shtesë për blerjen e disa minibusave për transportimin e gjithë deputetëve të Kuvendit. Ai tha se ne duhet të krijojmë kushte pune të barabarta për të gjithë deputetët.

Kryesuesi dha një kronologji të miratimit të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm. Mirëpo në atë Ligj, koalicioni "Kthimi" ka bërë një kundërshtim ndaj disa dispozitave të tij. Kryesuesi, më tej tha se ne në Kryesi të Kuvendit e kemi shqyrtuar atë kundërshtim dhe kemi formuluar një propozim konsesual të Kryesisë lidhur me te.

Propozimi konsesual, tha kryesuesi, është: Qeveria duhet të merrë masat e nevojshme për shtyrjen e zbatimit të klasës së 9-të edhe për një viti për pjestarët e komunitetit serb".

Kryesuesi tha se Qeveria e Kosovës e përkrahë këtë propozim. Ai i pyeti deputetët e koalicionit "Kthimi" se a e përkrahin propozimin e Kryesisë?

Oliver Ivanoviq tha se zbatimi i Ligjit, para këtij riformulimi, do të ishte pengesë për kthimin e të zhvendosurëve, kështu që tani u kemi dhënë kohë atyre edhe për një vit.

Fatmir Sejdiu dha sqarime se nuk ndryshohet ndonjë dispozitë në ligjin e miratuar më herët, por vetëm se shtyhet fillimi i klasës së 9-të e dhe për një vit për pjestarët e komunitetit serb.

Kryesuesi paraqet për votim propozimin konsesual të kryesisë. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për 69 vota.

Kundër 11 vota, dhe

Abstenime 7 vota.

Kryesuesi konstatoi se propozimi i Kryesisë së Kuvendit u miratua.

Kryesuesi hapi shqyrtimin lidhur me Rekomandimin e Panelit të posaçëm për Arsimin e Lartë.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Ministrisë së Arsimit, por askush nuk ishte i pranishëm.

Gojko Saviq tha se edhe përkundër faktit që ai nuk ishte pajtuar me atë rekomandim (ishte anëtar i panelit) dhe nuk e ka nënshkruar atë. As ministri i Arsimit z. Osmani, tha ai nuk është pajtuar me formulimin e këtij rekomandimi, por ky është Rekomandim që e ka formuluar kryesuesi i panelit z. James C O'Brien. Bisedat kanë zgjatur 2-3 ditë vazhdoi z. Saviq rreth formulimit të nenit 10 të ligjit në fjalë, për të rregulluar çështjen e Univerzitetit serb. Por, shtoi ai, se z. R. Osmani nuk është pajtuar me një ndryshim të tillë.

Arsim Bajrami tha se Ligji për Arsimin e Lartë nuk përmban asnjë dispozitë distriminuese, dhe se në hartimin e tij, përveç ekspertëve vendor, kanë marrë pjesë edhe ekspertët ndërkombëtar. Rekomandimi i panelit, vazhdoi ai, në aspektin juridik nuk është valid, pasi që për të nuk kanë votuar shumica (siç parashihet me Kornizën Kushtetute), dhe ai propozoi që ky rekomandim të refuzohet.

Bajram Kosumi tha se ky rekomandim nuk është i Panelit, ngase nuk e kanë votuar shumica e anëtarëve të tij, prandaj ai duhet të tërhiqet nga procedura e mëtejme, dhe të kërkohet nga PSSP ta shpall Ligjin për Arsimin e Lartë ashtu siç e ka miratuar ky Kuvend.

Kryesuesi ftoi deputetët që të votojnë për Rekomandimin e Panelit të posaçëm për Ligjin për Arsimin e Lartë.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për 21 vota,

Kundër 66 vota, dhe

Abstenime 5 vota.

Kryesuesi konstatoi se nuk është miratuar Rekomandimi i Panelit të posaçëm lidhur për Ligjin për Arsimin e Lartë të Kosovës.

3. Mbledhja vazhdoi punimet me pyetjet e deputetëve.

## PYETJET E DEPUTETËVE

1. Niman Alimusa kërkoi që në njërn nga mbledhjet plenare të shqyrtohet çështja e Bordit të Mediave.
2. Fatmir Rexhepi parashtrroi 3 pyetje. 1. Ai pyet Qeverinë se a ndien përgjegjësi për mosinplementimin e vendimit të Kuvendit për ndarjen e mjeteve komunës së Gjilanit lidhur me eliminimin e pasojave të termetit që e goditi me 24. prill të këtij viti. E dyta, pys Ministrinë e Financave se a ndien për obligim financimin e partive politike? Dhe e treta, Pys Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë pse ua ndalon shfrytëzimin e objekteve shkollore partive politike për nevojat e fushatës zgjedhore?
3. Bujar Dugolli pyet Ministrin e Arsimit.... pse nuk i është lënë mundësia që edhe nxënësit shqiptarë të shtyejnë klasën e 9-të për një vit sikur ata serb? Dhe pyetja e dytë (të njejtit ministër) në bazë të çkafit u jep premtime arsimtarëve për ngritjen e pagave?
4. Xhylishene Berisha parashtrroi dy pyetje; 1. kërkoi sqarim nga ministri i finansave pse ende nuk kan ndarë mjete për komunën e Gjilanit; 2. Pse janë kundërthënëse deklaratat e kryeministrit dhe ministrit të arsimit për ngritjen e pagave arsimtarëve?
5. Arsim Bajrami me pyetjen e tij i drejtohet Kryesisë së Kuvendit, Qeverisë së Kosovës dhe PSSP. Pse nuk përshpejtohet procedura për nxjerrjen e Ligjit për çështjet penale?
6. Fadil Kryeziu pyet kryetarin Nexhat Daci pse nuk e potencoi vonesën e pajisjes me dokumente të udhëtimit të fëmijëve të mërgimtarëve tanë në perendim të cilët kanë probleme tek PSSP?
7. FaikMarrolli p arashtrroi dy kërkesa; 1. Të rregullohet çështja e i munitetit të deputetëve, dhe 2. Të shihet se ku banojnë ashkalijtë dhe në çfarë kushte jetojnë ata.
8. Xhezair Murati pyet Qeverinë se a është në dijeni për shpërnguljen e popullatës së Dragashit, si e kalojnë kufirin dhe ku emigrojnë ata?
9. Sabir Rrustemi kërkoi nga Kuvendi që të formojë Komisionin për Media dhe 2. kërkon të dijë se çfarë raporti, bashkëpunimi midis Kryesisë së Kuvendit, Qeverisë dhe Presidencës.



10. Gani Prekopuca pyet ministrinë e Shërbimeve Publike se deri kur do të lejojë që dokumentacioni i kadastrit të Kosovës të jetë në Serbi?
11. Sahit Krasniqi pyet Qeverinë e Kosovës se a është duke e hartuar ndonjë ligj i cili do të definonte pronën?
12. Drita Statovci kërkon nga Ministria e Kulturës formimin e Operës.
13. Rangjel Nojkiq pyet (sekretarinë e Kuvendit) se çka është bërë me procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 11.7.2002 i cili është tërhequr nga mbledhja dhe më nuk i është dorëzuar deputetëve.
14. Ismajl Kurteshi kërkon nga Kryesia e Kuvendit që të fusë në rend dite çështjen e organizimit të brendshëm të Kuvendit, dhe të rishikohet pse po ngecin ndihëmat për komunën e Gjilanit?
15. Alush Gashi kërkoj nga Qeveria që të përgatisë një analizë për gjendjen në shëndetësi, me theks të veçantë në QKU dhe rekomandimet e saj.
16. Muhamed Kelmendi ia parashtror dy pyetje Kuvendit të Kosovës; 1. në njërën nga mbledhjet plenare të Kuvendit të shtrohet dhe debatohet çështja e rendit dhe e sigurisë në Kosovë, dhe 2. Kuvendi të kërkojë nga OSBE-ja shqarime dhe të dhëna konkrete se në çka e bazon kualifikimin për disa parti politike "demokratike" e disa "jodemokratike".
17. Vesna Ivanoviq pyeti Ministrinë e Ambientit dhe të Planifikimit Hapsinor pse materialet që arrijnë në komisionin përkatës të Kuvendit janë vetëm në gjuhën shqipe?
18. Sahit Krasniqi kërkoj nga Ministria e e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural që të hartojë një projektligj për mbrojtjen e prodhimeve bujqësore.
19. Berat Luzha pyeti Kuvendin pse nuk është formuar Komisioni i Kuvendit për hulumtimin e të zhdukurëve dhe pengjeve të luftës?
20. Besa Gaxheri pyeti OSBE-në se a mund të jetë më transparente me rastin e regjistrimit të popullatës serbe?
21. Bislim Hoti kërkon nga Kryesia e Kuvendit që shqyrtojë mundësinë e dhënies së ndihmave për popullatën e Gjakovës, e cila kishte psuar dëme nga fatkeqësitë natyrore kohë më parë.

22. Fatmir Sejdiu kërkon nga subjektet politike (pjesëmarrëse në Kuvend) që t'i delegojnë përfaqësuesit e vetë për formimin e Komisionit të Kuvendit për të cilin kërkoi z. Berat Luzha.

Mbledhja përfundoi në orën 12,40

Procesverbalin e hartoi

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,  
Akademik Nexhat Daci